



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS  
CENTAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA  
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER

## Qendra Kinematografike e Kosovës

**Datë: 19.11.2011**

Këshilli Drejtues i Qendrës Kinematografike të Kosovës i përbërë nga Arben Zharku - Kryesues, Burbuqe Berisha, , Ilir Kabashi dhe Arben Apolloni - anëtarë, në munges të anëtarit Agron Vula, i tubuar me datë 19.11.2011, pasi shqyrtoi vendimin e jurisë vlerësuese të konkursit për projekte filmike të datës 19.11.2011 solli këtë:

### V E N D I M

Të subvencionojë këto projekte:

#### 1. Filmi artistik i metrazhit të gjatë

Në kategorinë e filmit artistik të metrazhit të gjatë, në bazë të vendimit të jurisë, përzgjidhen këto projekte:

a) **“Tri dritare dhe një varje”** me skenar të **Zymer Kelmendit** dhe regji të **Isa Qosjas**, i shtëpive filmike **N.SH. “CMB”** dhe **P.K. “ISSTRA”**, subvencionohet me shumën prej **250,000.00€ (dyqindpesëdhjetëmijë euro)**.

b) **“Babai”** me skenar dhe regji të **Visar Morinës**, i shtëpisë filmike **N.SH. “Produksioni Krusha”**, subvencionohet me shumën prej **100,000.00€ (njëqindmijëmijë euro)**, me fuqi vepruese brenda vitit 2012, gjithmonë nëse producenti arrin të sigurojë mjete. Këtë të drejtë shtëpia filmike **N.SH. “Produksioni Krusha”** mund ta shfrytëzojë më së largu deri në 30 shtator të vitit 2012.

c) **“Njerëz të tepërt”** me skenar dhe regji të **Arben I. Kastratit**, i shtëpisë filmike **N.SH. “Some Kind Of Productions”**, subvencionohet me shumën prej **20,000.00€ (njëzetëmijë euro)**, për realizimin e post-produksionit.

d) **“Kthimi”** me skenar dhe regji të **Kastriot Abdylit**, i shtëpisë filmike **N.SH. “Shkupi Film”**, subvencionohet me shumën prej **29,000.00€ (njëzetëenëntëmijë euro)**, për pagesën e grupit të aktorëve nga Kosova.

e) **“Autobusi”** me skenar dhe regji të **Jeton Budimës**, i shtëpisë filmike **“City Film”**, subvencionohet me shumën prej **3,500.00€ (tremijëpesëqind euro)**, për zhvillimin e Skenarit sipas sugjerimeve të Jurisë, me kusht që të sjell skenarin e plotësuar para afatit të konkursit të ardhshëm të QKK-së.

## 2. Film artistik (metrazhi i shkurtër)

Në kategorinë e projekteve të filmave të shkurtër artistikë përzgjidhen për realizim:

a) **“Zëvendësimi”**, me skenar dhe regji të **Ilirjan Himajt**, i shtëpisë filmike **N.SH. “Tri dritare”**, subvencionohet me shumën prej **13,000.00€ (trembëdhjetëmijë euro)**.

b) **“Ne të tre”**, me skenar dhe regji të **Blerta Bashollit**, i shtëpisë filmike **N.T.SH. “Init Production”**, subvencionohet me shumën prej: **8,000.00€ (tetëmijë euro)**.

c) **“Përqafimi i fundit”**, me skenar dhe regji të **Lulzim Guhelli**, i shtëpisë filmike **N.T.SH. “CINEPRODUCTION”**, subvencionohet me shumën prej **1,500.00€ (njëmijëpesëqind euro)** për zhvillimin e Skenarit sipas sugjerimeve të Jurisë, me kusht që të sjell skenarin e plotësuar para afatit të konkursit të ardhshëm të QKK-së.

## 3. Filmi dokumentar

Në kategorinë e filmave dokumentarë përzgjidhen projektet:

a) **“Tingujt e rrënjës”**, me skenar dhe regji të **Shota Bukoshit**, i shtëpisë filmike **N.SH. “3V”**, subvencionohet me shumën prej **15,000.00€ (pesëmbëdhjetëmijë euro)**

- b) "Heil Hitler", me skenar dhe regji të **Alban Mujaj-t**, i shtëpisë filmike *N.Sh. "MF GR Media Film Productions"*, subvencionohet me shumën prej **5,000.00€ (pesëmijë euro)**

#### 4. Film i animuar

Në kategorinë e filmit të animuar përzgjidhet projekti "Përtej", me skenar dhe regji të **Nexhat Krasniqi**, i shtëpisë filmike "Studio Nekra", i cili subvencionohet me shumën prej **20,000.00€ (njëzetmijë euro)**

#### Anëtarët e Këshillit Drejtues:

1. Arben Zharku - Kryesues
2. Burbuqe Berisha - Anëtar
3. Ilir Kabashi - Anëtar
4. Arben Apolloni - anëtar

